This paper seeks to critically study the integration of artificial intelligence (AI) in India's college education sector, with a specific focus on rural areas. Utilizing a critical policy research framework, it examines the implications of current and proposed policies and strategy papers emphasizing the distinctive challenges and opportunities in rural higher education contexts. As various studies have illustrated, rural colleges in India confront considerable obstacles, including inadequate access to quality faculty, insufficient infrastructure, and a dearth of localized, context-specific learning resources. The National Strategy for Artificial Intelligence, directed by the Indian government, identifies education as a key focus area, recommending AI-assisted interventions such as smart content, and the prediction of drop-outs, to address resource gaps. Adopting a critical policy research approach, this paper explores how social hierarchies, class and caste concerns, economic concerns and the digital divide shape AI deployment in rural college education. The importance given to the private tech companies in providing AI solutions foregrounds concerns about profit motives in contrast to the 'greater good' that the Indian AI policy papers declare. This research underscores that there is a necessity to prioritize other related developments and social justice to properly facilitate AI-driven improvements in rural college education.

Keywords: AI, education, India, rural students, AI policy, critical policy research

AI-generated Deep Fakes, Nigeria 2023 democracy and Elections

Samuel Uwem

University of Hradec Kralove, Czech.

Email: samumo800@gmail.com

Abstract

Artificial intelligence is increasingly used in political communications, electoral campaigns and elections in African countries like Nigeria. Using the 2023 Nigeria presidential election as a pivot point, this paper analyzes how Nigeria's presidential election was inundated with election disinformation, AI-generated deepfakes, and how it threatened the 2023 elections. Data was generated from the European Union Election Observation Mission report, news mapping, observation and an online survey of 250 registered voters in two Southeast Nigeria states. The paper argues that AI is a two-edged sword that could improve the democratic process and help citizens better understand politics. Yet, it could also undermine the democratic process by voting suppression.

Keywords: election, disinformation, AI-generated deepfakes, democracy

Machine Learning Poisoning: How Attackers Can Manipulate AI Models for Malicious Purposes

Shahmeer Amir

Web Application Security Researcher

Network Security Analyst

Email: shahmeerbond@gmail.com

Abstract

The use of machine learning and artificial intelligence has been on the rise in various industries, including the field of cybersecurity. These technologies have shown great potential in detecting and mitigating cyber threats, but they also come with their own set of risks. One of the most significant risks is the threat of machine learning poisoning attacks. Machine learning poisoning attacks involve an attacker manipulating the data or the learning algorithm used by an AI model to compromise its accuracy or functionality. This type of attack is particularly dangerous because it can go undetected for a long time, and it can be challenging to trace its origins. A successful poisoning attack can result in the AI model making incorrect decisions, which can lead to a security breach or data loss. The session will cover practical steps that organizations can take to prevent machine learning poisoning attacks. These measures include data validation, monitoring the performance of AI models, and implementing adversarial training techniques. Attendees will learn how to implement these measures and ensure that their systems are protected against machine learning poisoning attacks. Attendees will gain insights into how these attacks were executed, and the lessons learned from them. The presentation will also include case studies of high-profile machine learning poisoning attacks, highlighting the impact they had on the organizations targeted.

Keywords: machine learning, artificial intelligence, cybersecurity, poisoning attacks, data validation.

Business and artificial intelligence

Shpëtim Memishi

AAB College, Prishtina, Republic of Kosova

Email: shpetim.memishi@universitetiaab.com

Abstract

Artificial intelligence has gained a lot of momentum these days and is a huge challenge for developing countries or even those countries that have tried to adapt to intelligence very quickly and have encountered various difficulties. Businesses through artificial intelligence have the opportunity to obtain primary information as quickly and easily as possible from intelligence, which until the last century was a challenge or even an impossibility to obtain this information so quickly and easily. Kosovo, as a new country, today needs as much as possible to have access to this artificial intelligence to lobby and also to bring in foreign investors who want to invest in businesses as well as in different sectors, e.g. agriculture, livestock, business infrastructure, as well as in opening factories for various products such as: automobiles, shoes, airplanes, helicopters, etc. In addition to businesses, this also enables the youth of our country to have the opportunity to receive as much information as possible about their training in studies as well as if they intend to invest in their country and find cooperation with businesses, whether local or from other European or Balkan countries. Intelligence also enables businesses to exchange and train their staff or workers with developed countries such as the USA, Germany, France, Albania, etc., since access is much easier due to its infrastructure and also due to the now freer and unrestricted movements from other countries.

Keywords: businesses, intelligence, production, Europe, Balkans, America, Kosovo.

The Impact of Artificial Intelligence on The Teaching-Learning Process, Case Study Schools in Prishtina

Valbona Krasniqi

AAB College, Prishtina, Republic of Kosova

Email: valbona.krasnici@universitetiaab.net

Abstract

The fast growth of artificial intelligence (AI) is altering education and influencing how students learn. This study employs both qualitative and quantitative methodologies to examine the influence of AI on the learning process at the Schools in Prishtina. The emphasis is on determining the impact of AI-powered solutions like as intelligent tutors, tailored learning platforms, and data analytics on student achievement. The findings demonstrate that AI boosts student engagement, enhances learning personalization, and makes progress tracking easier. However, problems have been highlighted, including a lack of technology skills and the need for more relevant educational programs. The report underlines AI's potential to alter education and makes recommendations for its deployment in educational institutions.

Keywords: Artificial Intelligence, Teaching and Learning, Educational Technology, Education System Transformation.

The Impact of AI on International Business Strategy

Vjollca V. Hasani

Shaip Bytyci

AAB College, Prishtinë, Republic of Kosova

Email: shaip.bytyqi@universitetiaab.com

Abstract

This study investigates how artificial intelligence (AI) is influencing global business strategy.

With an emphasis on multinational companies (MNCs), this study examines how artificial intelligence (AI) is transforming international business tactics. It explores how MNCs use AI to improve competitive analysis, market entrance, and international expansion. The research emphasizes how to discover developing markets, maximize operational efficiency, and evaluate rival tactics by utilizing AI-driven data insights, machine learning algorithms, and predictive analytics. It demonstrates the strategic benefits AI offers in managing the intricacies of international business settings and expanding operations by examining case studies and practical implementations. The paper also looks at how AI helps with localization efforts, real-time monitoring of global trends, and negotiating cultural and regulatory challenges. It illustrates via case studies the strategic benefits that multinational corporations (MNCs) receive from incorporating AI into their global business models. This integration allows MNCs to make data-driven choices, lower risks, and grow their operations more successfully in a variety of foreign markets.

Keywords: Artificial Intelligence, multinational corporations, data-driven strategy, business strategy, market trends.

The Effect of Artificial Intelligence on Human Resource Management: Workforce Implications and Ethical Issues

Khavit Islami¹

Enis Mulolli²

¹AAB College, Prishtina, Republic of Kosova

²SK Research – Oxford Business College, UK

E-mail: enis.mulolli@obc.ac.uk

Abstract

This paper aims to examine the effect of Artificial Intelligence (AI) on human resource management (HRM), focusing on the implications of AI adoption in the workplace, workforce reduction, and the ethical issues it presents. Study a systematic literature review was conducted to explore the decision-making processes of managers regarding AI investment, its impact on jobs, and the ethical dilemmas arising from AI integration in management, particularly in human resources. The findings highlight that AI investments may lead to workforce reductions, especially in roles requiring lower intellectual labor, but also present opportunities for workers to focus on tasks AI cannot perform. Additionally, AI is reshaping traditional human resource management paradigms by prioritizing automation over human-centered decision-making, raising concerns about job security and management's human values. Ethical issues such as biases, accountability, and privacy in AI applications, especially in recruitment, were identified as significant challenges. This paper offers a critical evaluation of AI's impact on human resource management, emphasizing the need for a balanced approach that ensures transparency, accountability, and fairness in AI systems. The study contributes to understanding AI's ethical implications in HRM and organizational management, urging responsible AI implementation.

Keyword: Artificial Intelligence; Human Resource Management; Workforce Implications; Ethical Issues.

Artificial Intelligence in Public Administration - Opportunities and Implementation Challenges

Xhemazie Ibraimi

AAB College, Prishtina, Republic of Kosova

Email: xhemazie.ibraimi@universitetiaab.com

Abstract

Public administration is undergoing a profound transformation driven by artificial intelligence (AI), marking a shift from traditional governance models to automated, data-driven decision-making processes. This evolution, part of broader digital governance reforms, increases efficiency, reduces bureaucratic hurdles and improves service delivery to citizens. This study aims to critically examine the impact of AI on public administration by analyzing its potential to optimize administrative workflows, strengthen policy implementation and increase public sector innovation. The research uses a comparative methodology, drawing on case studies from different countries to assess best practices and challenges in adopting AI. Key areas of focus include automation in public services, ethical considerations, algorithmic transparency and the need for regulatory frameworks that protect equity and accountability. The findings show that AI holds significant promise in streamlining administrative processes and fostering evidence-based policymaking. However, challenges such as algorithmic bias, legal uncertainties, data privacy concerns and the digital skills gap among civil servants pose significant obstacles to effective implementation. The study highlights the need for a strategic approach that integrates robust regulatory policies, AI ethical frameworks and capacity building initiatives to ensure that AI adoption is aligned with democratic values and public trust.

Keywords: artificial intelligence (AI), public administration, digital governance, automation, algorithmic transparency, e-government.

Enhancing Speaking Competence in English Philology Profile: The Role of AI Tools in Higher Education

Zarrina Salieva

Samarkand State Institute of Foreign Languages, Uzbekistan

Email: zarrinasalieva777@gmail.com

Abstract

Artificial Intelligence (AI) technologies are becoming increasingly important in improving language acquisition, especially in teaching speaking skills, as higher education embraces technological advancements. Strong oral communication abilities are crucial for university students' academic achievement, career readiness, and international engagement. The paper investigates the effective AI-driven tools for teaching speaking to higher education students with a philological profile, focusing on how they may provide particular feedback, simulate real-world professional communication scenarios, and support self-directed learning. Moreover, Artificial intelligence (AI) tools allow for more personalised and effective practice by providing students with instant feedback on their pronunciation and fluency. The article also examines the drawbacks of modern technologies, such as their inability to fully imitate human interaction and the moral challenges created by data privacy. The article concludes with practical advice for educators and students on effective usage of AI driven tools while overcoming challenges in language teaching and learning.

Keywords: Artificial Intelligence, teaching speaking, English, philological profile, higher education.

The Role of Artificial Intelligence in Personalizing Workouts and Optimizing Performance in Fitness

**Zenel Metaj, Nazim Myrtaj, Shkelzen Shala,
Blerim Sylejmani, Arben Maliqi, Abedin Ibrahimi**

AAB College, Prishtinë, Republic of Kosovo

Email: nazim.myrtaj@universitetiaab.com

Abstract

The fitness industry is undergoing a significant transformation due to the integration of artificial intelligence (AI). AI-based technologies, such as personalized workout applications, smart devices, and biometric analysis algorithms, are playing a crucial role in optimizing exercises and monitoring individual progress. The purpose of this paper is to examine the impact of artificial intelligence on the fitness industry, analyzing how advanced technologies assist in personalizing workouts, tracking performance, and preventing injuries. Additionally, the paper aims to identify the challenges and opportunities AI presents in enhancing physical health and well-being. By relying on case studies and empirical analyses, the paper seeks to provide a clear overview of the potential and challenges of AI in modern fitness.

Keywords: Artificial Intelligence (AI), progress monitoring, injury prevention, fitness applications, digital trainers, fitness technology.

From Natural Language Processing to Large Language Models: Redefining Translation in the Age of AI

Afrim Hyseni

Translator, Kosovo

Email: afrim.hyseni@trankos.com

Abstract

In the early 1960s, Natural Language Processing (NLP) started as a specialized area of research, where linguists and computer scientists worked on teaching machines to process human language. Over the decades, this curiosity evolved, moving through rule-based systems, statistical models, deep learning breakthroughs, and finally to Google's "Attention Is All You Need" paper in 2017, which changed the field forever. Today, Large Language Models (LLMs) like GPT-4 have brought language understanding to a new level. They do not simply translate by replacing words; they capture the meaning behind text and rebuild it naturally in another language. Translation has become a process of recognizing meaning across different languages, instead of simply matching phrases. In this presentation, I will touch on key steps from early NLP to the powerful AI tools we have today. I will explain why traditional definitions of translation, focused only on human skills, are no longer enough. Based on what LLMs can now do which is understanding context, resolving ambiguity, and adapting to culture, I will propose a new way to define translation for the future. Bringing this discussion in Kosovo is especially meaningful, as Kosovo is a place where language, culture, and identity have always been closely connected.

Keywords: Natural Language Processing (NLP), Machine Translation, Large Language Models (LLMs), Artificial Intelligence (AI), Generative AI.

Autori Algoritmik: Si Inteligjenca Artificiale po Transformon Kreativitetin në Film dhe Media

Ajmone Salihu

Kolegji AAB, Prishtina, Kosovë

Email: ajmone.salihu@universitetiaab.com

Abstrakt

Inteligjenca artificiale (IA) po bëhet një forcë transformuese jo vetëm në jetën e përditshme, por edhe në industrinë e medias dhe krijimtarisë. Në film dhe televizion, mjetet e fuqizuara nga IA po ndryshojnë shkrimin e skenarit, regjisë dhe narrativës vizuale, duke automatizuar procese që dikur konsideroheshin të lidhura ekskluzivisht me imagjinatën njerëzore. Teknologjitë e të mësuarit të thellë tani mund të shkruajnë skenarë, të redaktojnë filma dhe të krijojnë aktorë dixhitalë, duke imituar stile artistike dhe parashikuar shijet e audiencës, shpesh me një saktësi befasuese. Ky studim shqyrton pasojat e konceptimit të IA-së si një bashkëpunëtor krijues në vend të një mjeti të thjeshtë, duke analizuar ndikimin e saj në autenticitetin artistik dhe tregun e punëve krijuese. A mund IA ta zëvendësojë vërtet autorin, apo thjesht e zgjeron vizionin e tij, duke e çuar krijimtarinë në një drejtim të ri? Duke analizuar raste studimore të filmave, skenarëve dhe artit dixhital të krijuar nga IA, ky hulumtim eksploron nëse këto teknologji po demokratizojnë krijimin e mediave apo po homogjenizojnë shprehjen artistike. Në një fushë të ndërtuar mbi intuitën dhe emocionet njerëzore, IA sfidon perceptimet tona mbi natyrën e krijimtarisë, rolin e artistit dhe kufijtë e imagjinatës njerëzore në epokën digjitale.

Fjalë kyç: inteligjenca artificiale, autenticiteti artistik, bashkëpunimi krijues.

Impakti i Inteligjencës Artificiale në Lehtësimin e Punëve në Mediat Sociale, Rast Studimi: Office Shoes, Kosovë

Ajshe Ismajli

Ali Ismajli

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: ali.ismajli@universitetiaab.com

Abstrakt

Inteligjenca Artificiale (IA) po revolucionarizon mënyrën se si bizneset menaxhojnë dhe ndërveprojnë nëpër media sociale, duke automatizuar procese dhe përmirësuar efikasitetin. Ky studim analizon rolin e IA-së në lehtësimin e punëve në mediat sociale, me një fokus të veçantë në rastin e Office Shoes Kosovë. Nëpërmjet analizës së të dhënave, do të analizohet se si zbatimi i mjeteve të bazuara në IA, analiza e të dhënave, dhe personalizimi i përmbajtjes ka ndikuar në produktivitet, angazhimin e klientëve dhe kthimin mbi investimin. Rezultatet tregojnë se IA jo vetëm ka reduktuar ngarkesën operative të ekipeve, por ka edhe përmirësuar saktësinë e targetimit dhe shpejtësinë e përgjigjeve ndaj konsumatorëve. Sidoqoftë, studimi nxjerr në pah edhe sfidat, si depërtimi i kufizuar në treg dhe nevojën për trajnim të stafit. Këto gjetje ofrojnë një kuadër të vlefshëm për bizneset lokale që synojnë të integrojnë IA në strategjitë e tyre sociale, duke theksuar ekuilibrin midis automatizimit dhe prekjes njerëzore.

Fjalë kyç: inteligjenca artificiale (IA), mediat sociale, efikasiteti i automatizimit, analiza e të dhënave

Perceptimet e Studentëve të Kolegjit AAB mbi Përdorimin e ChatGPT në Arsimin e Lartë: Studim Rasti

Alberita Hylaj,

Bletë Jerliu

Lirika Bërdynaj Syla

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: blete.jerliu@universitetiaa.com

Abstrakti

Ky studim eksploron perceptimet e studentëve të kolegjit AAB mbi përdorimin e ChatGPT në arsimin e lartë, duke u fokusuar në përvojat dhe qëndrimet e tyre ndaj këtij mjeti të inteligjencës artificiale. Hulumtimi është realizuar përmes një qasjeje cilësore, duke përfshirë 30 studentë të vitit të tretë në shkencat sociale, të përzgjedhur me mënyrën e kampionimit top dëbore. Të dhënat janë mbledhur përmes intervistave gjysmë të strukturuar, duke mundësuar një analizë të hollësishme të ndikimit të ChatGPT në proceset e të nxënës, angazhimin akademik dhe zhvillimin e aftësive kritike. Analiza tematike është përdorur për të analizuar të dhënat nga intervistat. Rezultatet tregojnë se shumica e studentëve e perceptojnë ChatGPT si një mjet mbështetës që përmirëson qasjen në informacion, kursen kohën dhe nxit krijimin e ideve të reja. Megjithatë, ata identifikojnë disa sfida, si vlerësimin e saktësisë dhe besueshmërisë së informacionit të ofruar. Për të adresuar këto sfida, studimi sugjeron disa strategji, përfshirë verifikimin e informacionit me burime të besueshme, përdorimin e ChatGPT si mjet këshillimi dhe ofrimin e udhëzimeve të qarta për përdorim të përgjegjshëm. Studimi thekson rëndësinë e një qasjeje etike në integrimin e AI në arsimin e lartë dhe ofron rekomandime për optimizimin e përdorimit të ChatGPT në procesin mësimor dhe pedagogjik.

Fjalë kyç: ChatGPT, arsimi i lartë, studentët, sfidat, përfitimet

Siguria e të Dhënave në Sistemet Operative që Përdorin Teknologjitë e reja si Ai Dhe IoT

Alketa Gashi

Ersan Hamdiu

Fehmi Hysenaj

Kolegji AAB, Prishtina, Kosovë

Email: ersan.hamdiu@universitetiaab.com

Abstrakt

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale (AI) dhe Internet of Things (IoT) në sistemet operative ka sjellë përmirësime të mëdha, por gjithashtu ka krijuar sfida të reja në sigurinë e të dhënave. Punimi shpjegon se si AI mund të bëhet objekt i sulmeve kundërshtarë, ku algoritmet manipulohen për të prodhuar rezultate të pasakta. Nga ana tjetër, pajisjet IoT shpesh kanë mekanizma të dobët sigurie, duke i bërë ato të cenueshme ndaj hyrjeve të paautorizuara. Këto rreziqe mund të sjellin pasoja serioze, përfshirë humbjen e konfidencialitetit dhe integritetit të të dhënave. Për të përballuar këto kërcënime, organizatat duhet të zbatojnë strategji të forta sigurie. Këto përfshijnë enkriptimin e të dhënave, kontrollet e avancuara të aksesit, zbulimin e anomalive në kohë reale dhe përdorimin e enklavave të sigurta. Gjithashtu, adoptimi i një qasjeje proaktive për menaxhimin e rreziqeve kibernetike është thelbësor për të siguruar mbrojtjen e sistemeve operative. Ky punim thekson rëndësinë e implementimit të protokolleve gjithëpërfshirëse të sigurisë për të mbrojtur sistemet që integrojnë AI dhe IoT, duke garantuar mbrojtjen e të dhënave nga sulmet kibernetike.

Fjalë kyç: AI, IoT, enkriptimi, Python, mbrojtja, pasojat, Linux.

Ndërlidhja në mes të Nomofobisë dhe Varësisë nga Inteligjenca Artificiale

Ertan Basha

Armen Mustafa

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: armen.mustafa@aab-edu.net

Abstrakt

Nomofobia ose frika nga mungesa e telefonit mobil, është bërë një shqetësim në rritje, veçanërisht tek studentët universitarë. Ky studim shqyrton korrelacionin në mes të nomofobisë dhe varësisë nga IA. Për këtë fillimisht do të përdoret një bazë e të dhënave, të mbledhur nga 841 studentët përmes anketave. Këto të dhëna janë analizuar duke përdorur statistika përshkruese dhe analizën e korrelacionit të Pearson. Pastaj studimi synon të integrojë teknikat e Inteligjencës Artificiale (IA), veçanërisht modelet e të mësuarit makinerik, për të parashikuar nivelet e nomofobisë bazuar në faktorë demografikë dhe psikologjikë. Gjithashtu, ky studim vë në pah potencialin e IA në studimet psikologjike dhe të sjelljes, duke ofruar një qasje të bazuar në të dhëna për zbulimin e nomofobisë. Përmes modeleve të parashikimit të drejtuara nga IA, ky hulumtim synon të përmirësojë strategjitë e identifikimit të hershëm dhe ndërhyrjes për individët që janë të prirur ndaj nomofobisë. Gjithashtu, gjetjet do të ndihmojnë në zhvillimin e ndërhyrjeve të asistuar nga IA në shëndetin mendor, duke i mundësuar universiteteve dhe psikologëve krijimin e programeve të mbështetjes së synuar për studentët që luftojnë me varësinë ndaj telefonave mobil.

Fjalë kyç: nomofobia, inteligjenca artificiale, mësimi makinerik, studentët.

Qeverisja Elektronike

Arnesa Sahiti

Universiteti "Kadri Zeka", Gjilan, Kosovë

Email: arnesa.sahiti@uni-gjilan.net

Abstrakt

Ky punim shqyrton sfidat dhe mundësitë në administratën publike dhe qeverisjen bashkëkohore, me fokus në reformat institucionale dhe transparencën e institucioneve publike. Analizohet ndikimi i dixhitalizimit dhe e-qeverisjes në përmirësimin e shërbimeve publike, duke sjellë një vështrim mbi automatizimin dhe modernizimin e tyre. Përmes metodave cilësore dhe sasiore, studimi vlerëson ndikimin e politikave publike në administratën shtetërore. Analiza krahasimore e modeleve të ndryshme të qeverisjes paraqet praktikat më të mira që mund të aplikohen për të rritur efikasitetin dhe transparencën në sektorin publik. Gjetjet tregojnë se një administratë publike e reformuar dhe e modernizuar është thelbësore për një qeverisje efektive dhe ndërtimin e një shteti demokratik. Investimi në inovacion, përmirësimi i politikave publike dhe ngritja e kapaciteteve institucionale janë ndër rekomandimet kryesore që dalin nga ky studim. Ky punim synon të kontribuojë në diskursin akademik dhe profesional mbi administratën publike, duke ofruar një perspektivë mbi sfidat dhe zhvillimet e ardhshme në këtë fushë.

Fjalë kyç: qeverisja elektronike, reformat institucionale, transparenca, dixhitalizimi, efikasiteti administrativ

Roli i Inteligjencës Artificiale në Planifikimin e Buxhetit të shtetit të Kosovës

Bedri Hamza

Medain Hashani

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: medain.hashani@aab-edu.net

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është të përcaktoj se cili do të jetë roli i inteligjencës artificiale në planifikimin e buxhetit, duke marrë për bazë edhe pjesën e dukurive negative siç janë inflacioni dhe krizat ekonomike potenciale të cilat mund të ndikojnë në mosrealizimin e buxhetit. Sistemet e mëparshme do të zëvendësohen nga Qeveria Digjitale dhe do të eliminohen kufizimet mbi inovacionin dhe do të ngritët transparenca e llogaridhënies nga inteligjenca artificiale. Në kuadër të metodologjisë do të përdoret metoda e deduksionit. Gjetjet nga ky punim tregojnë se do të rritet transparenca e Qeverisë së Kosovës dhe do të rritet efikasiteti në planifikimin e buxhetit dhe inteligjenca artificiale do të detektoj projektet të cilat do të ishin të panevojshme. Rezultatet nga ky punim do të përdoren nga Qeveria e Kosovës. Përfundimet nga ky punim tregojnë se rritja e efikasitetit, planifikimi efektiv i buxhetit dhe matja e riskut do të reflektojnë që mos të ketë dështime në realizimin e Buxhetit të Shtetit si dhe inteligjenca artificiale të bënë paralajmërime nëse paraqiten kriza ekonomike apo trendi inflacionit është në rritje.

Fjalë kyç: planifikimi, inteligjenca artificiale, risku, qeveria digjitale, inflacioni, kriza

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale për Zbulimin dhe Parandalimin e Sulmeve Kibernetike

Benita Sylejmani

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: benita.sylejmani@universitetiaab.com

Abstrakt

Ky punim analizon ndikimin e Inteligjencës Artificiale (IA) në transformimin e mënyrës së menaxhimit dhe mbrojtjes së sistemeve tona kundër sulmeve kibernetike. IA ofron potencial të jashtëzakonshëm për të identifikuar modelet e sulmeve dhe për t'i parandaluar ato, duke përdorur teknologji të avancuara si mësimi i thellë dhe analiza e të dhënave. Në mënyrë specifike, punimi trajton disa aspekte kryesore të aplikimit të IA-së në sigurinë kibernetike: përmirësimi i reagimeve ndaj incidenteve të sigurisë, avancimi i analizave të rrezikut dhe integrimi me mjetet ekzistuese të sigurisë. Gjithashtu, theksohen sfidat e përdorimit të IA-së, përfshirë problemet me të dhënat, ndjeshmërinë ndaj sulmeve të sofistikuara dhe nevojën për trajnime të vazhdueshme të modeleve. Në punim përfshihet një krahasim i detajuar i tre aplikacioneve të IA-së që analizojnë sulme kibernetike, duke nxjerrë në pah dallimet në mënyrën e funksionimit dhe efektivitetin e tyre. Në përfundim, jepet një panoramë e qartë se si IA mund të luajë një rol të rëndësishëm në përforcimin e mbrojtjes kibernetike dhe të sigurojë sisteme më të forta për t'u përballur me kërcënimet në rritje të botës dixhitale.

Fjalë kyç: IA, analizë, trajnim, sulm kibernetik, mbrojtje, detektim

Sfidat e bizneseve në epokën e inteligjencës artificiale: adaptimi, etika dhe konkurrenca

Blerta Haliti Baruti

Fjolla Trakaniqi

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: fjolla.trakaniqi@universitetiaab.com

Abstrakt

Inteligjenca artificiale (IA) po sjell ndryshime thelbësore në mënyrën se si bizneset operojnë, duke ofruar automatizim, efikasitet dhe vendimmarrje të avancuar. Megjithatë, përfshirja e IA në tregjet në zhvillim, si Kosova, përballët me sfida të shumta, përfshirë mungesën e infrastrukturës teknologjike, kostot e larta të implementimit dhe nevojën për fuqi punëtore të kualifikuar. Për më tepër, çështjet etike dhe shqetësimet mbi privatësinë e të dhënave paraqesin pengesa shtesë për adoptimin e gjerë të këtyre teknologjive. Ky studim analizon ndikimin e IA në sektorët kryesorë të ekonomisë, duke u fokusuar te tregtia dhe shërbimet, ku përdorimi i teknologjive të avancuara mund të sjellë përfitime të konsiderueshme, por edhe sfida të ndërlikuara. Nëpërmjet rishikimit të literaturës dhe analizës së rasteve studimore nga kompani vendore, hulumtimi nxjerr në pah vështirësitë që hasin bizneset në përshtatjen me transformimin digjital. Rezultatet tregojnë nevojën për strategji të qarta që mbështesin zhvillimin e aftësive digjitale, rregullimin e duhur ligjor dhe investimet në teknologji për të lehtësuar tranzicionin drejt një ekonomie më të automatizuar dhe inovative.

Fjalë kyç: inteligjenca artificiale, sfida të biznesit, Kosovë, transformim digjital, etikë.

Qeverisja dixhitale dhe roli i inteligjencës artificiale në transformimin e sektorit publik

Blinera Veliu

Kolegji AAB, Prishtinë

Email: blinera.veliu@universitetiaab.com

Abstrakt

Në kohën e transformimeve të thella teknologjike, administratat publike gjenden përballë një dinamike të re sfidash dhe mundësish të cilat burojnë nga avancimi i inteligjencës artificiale (IA). Ky studim synon të trajtojë rolin e IA në kuadër të qeverisjes dixhitale dhe transformimit të sektorit publik, duke analizuar mënyrën se si teknologjitë e avancuara po ndikojnë në rikonceptimin e ofrimit të shërbimeve publike, në përmirësimin e ndërveprimit me qytetarët dhe në rritjen e efikasitetit të funksionimit administrativ. Qëllimi parësor është të vlerësohen përfitimet potenciale dhe kufizimet e aplikimit të IA në administratën publike, me fokus të veçantë në kontekstin institucional dhe zhvillimor të Kosovës. Metodologjia e hulumtimit bazohet në analizën dokumentare dhe krahasuese të praktikave ndërkombëtare, si dhe në shqyrtimin kritik të politikave kombëtare të qeverisjes dixhitale. Gjetjet tregojnë se IA ofron mundësi për rritjen e transparencës, automatizimin e proceseve dhe mbështetjen e vendimarrjes së bazuar në të dhëna, por paralelisht ngre shqetësime etike, juridike dhe sociale, veçanërisht në lidhje me privatësinë dhe qasjen e barabartë. Në përfundim, theksohet nevoja për ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe për hartimin e politikave gjithëpërfshirëse që mundësojnë integrimin e qëndrueshëm dhe të përgjegjshëm të IA në administratën publike.

Fjalë kyç: qeverisje dixhitale, inteligjencë artificiale, administratë publike, transformim teknologjik, efikasitet institucional, etikë.

Metodologjia e Transformimit Kreativ: Rasti i Anime-s së Krijuar me AI

Ertan Iliyaz

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: ertan.iliyaz@universitetiaab.com

Abstrakt

Ky studim praktik analizon procesin krijues të prodhimit të videos së parë zyrtare anime "ARIA" duke shfrytëzuar mjete AI. Përmes një qasjeje trefazore (konceptualizimi me Midjourney, Glam Lab dhe CapCut), demonstrohet se si teknologjia e transformimit mund të sintetizojë elementë kulturore të Kosoves në forma moderne arti vizual. Fokusi im i veçantë është vendosur në sfidën e ruajtjes së autenticitetit kulturor gjatë procesit të gjenerimit automatik, duke ofruar zgjidhje inovative për inkorporimin e motiveve tradicionale Japonisë në ambiente dixhitale. Rezultatet tregojnë se kombinimi i algoritmeve Generative AI me inpute video manuale artistike mund të krijojë vepra që ruajnë 78% e karakteristikave kulturore origjinale ndërsa reduktojnë kohën e prodhimit me 92%. Studimi konkludon me një model referimi për krijimtarinë e udhëhequr nga AI, duke bërë integrimin e teknologjisë transformuese në proceset kulturore pa komprometuar identitetin artistik.

Fjalë kyç: Generative AI, transformimin kreativ, anime-je me AI, integrimi i autenticitetit kulturor, integrimin teknologjik, art-vizual.

Inteligjenca artificiale si motor i transformimit digjital në sektorin administrativ

Erza Lipa

Shkumbin Misini

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: shkumbin.misini@universitetiaab.com

Abstrakt

Transformimi digjital i sektorit administrativ po rishpien mënyrën tradicionale të ofrimit të shërbimeve publike dhe private, ku Inteligjenca Artificiale (IA) luan një rol transformues. Ky studim eksploron se si teknologjitë e IA përfshirë përpunimin e gjuhës natyrore, automatizimin e proceseve robotike dhe analizën e të dhënave po revolucionarizojnë efikasitetin, transparencën dhe ndërveprimin me qytetarët në administratë. Nëpërmjet analizës së rasteve studimore dhe të dhënave analizuuese, hulumtimi identifikon tre ndikimet kryesore të IA: (1) reduktimin e ngarkesës administrative përmes automatizimit, (2) përmirësimin e vendimmarrjes me algoritme të optimizuara, dhe (3) personalizimin e shërbimeve për përdoruesit. Gjithashtu, studimi hedh dritë mbi sfidat praktike, si çështjet e privatësisë, rezistencën ndaj ndryshimit dhe nevojën për infrastrukturë dixhitale. Analiza e Inteligjencës Artificiale nuk është thjesht një mjet, por një *motor* thelbësor për transformimin administrativ, duke kërkuar një strategji të qëndrueshme të integritit që balancon inovacionin me rreziqet që na pret e ardhmja.

Fjalë kyç: inteligjencë artificiale (IA), transformim digjital, automatizim i proceseve administrative, efikasitet institucional.

Ndikimi i përdorimit të kanaleve të ndryshme në marketingun dixhital: rasti i platformave të mediave sociale dhe marketingut me email

Etleva Namligjiu

Adelina Gashi

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: adelina.gashi@universitetiaab.com

Abstrakt

Bizneset dhe organizatat përballen me vështirësinë e zgjedhjes së kanaleve më efikase për të arritur dhe angazhuar klientët e tyre në dritën e përparimeve të shpejta në teknologji dhe ndryshimeve të vazhdueshme në peizazhin e marketingut dixhital. Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë se si marketingu me email dhe përdorimi i mediave sociale ndikojnë në efikasitetin dhe performancën e taktikave të marketingut dixhital. Studimi vlerëson funksionin e çdo kanali në angazhimin e konsumatorit, ndërgjegjësimin e markës dhe kthimin e përdoruesve në konsumatorë aktivë duke rishikuar literaturën dhe duke analizuar të dhënat aktuale duke përdorur një qasje metodologjike të përzier. Rezultatet tregojnë se, megjithëse platformat e mediave sociale ofrojnë përfitime në nxitjen e angazhimit dhe zgjerimin e shtrirjes së komunikimeve të marketingut, marketingu me email vazhdon të jetë një instrument i fortë për personalizimin e ndërveprimit dhe krijimin e lidhjeve të qëndrueshme me klientët. Hulumtimi përfundon me sugjerime të zbatueshme për mënyrën më të mirë për të kombinuar këto kanale për të rritur efektivitetin e qasjeve të marketingut dixhital dhe për të rritur produktivitetin e përpjekjeve të reklamimit.

Fjalë kyç: marketing dixhital, media sociale, marketing me email, angazhimi i konsumatorëve, strategji të marketingut.

Inteligjenca artificiale dhe ndikimi i saj në të drejtat e njeriut

Evanthi Suli, Juriste
Irgena Dokollari, Avokate
Email: irgenadokollari7@gmail.com

Abstrakt

Ndërsa teknologjia po përparon dita ditës, ndikimi i inteligjencës artificiale në të drejtat themelore të njeriut po bëhet gjithnjë e më i dukshëm. Edhe pse sistemet e inteligjencës artificiale kanë potencialin e duhur për të rritur ndjeshëm mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, në fakt ditët e sotme përdorimi i inteligjencës artificiale në jetën e përditshme po shoqërohet me rreziqe serioze që cenojnë të drejtat e njeriut përmes aplikimit të diskriminimit, pabarazisë gjinore, kërcënimeve ndaj proceseve demokratike dhe cenimit të integritetit e dinjitetit njerëzor. Në këtë kuadër, ky artikull shkencor do të trajtojë dhe analizojë mënyrën sesi inteligjenca artificiale po transformon shoqërinë tonë, duke ndikuar thellësisht jo vetëm mënyrën se si ne jetojmë dhe ndërveprojmë, por edhe në gëzimin e të drejtave themelore të njeriut. Por çfarë do të kuptojmë me termin inteligjencë artificiale? Cilat janë të drejtat themelore të njeriut që po cenohen nga keqpërdorimi i inteligjencës artificiale? Cilat janë instrumentat ligjore që parashikojnë mekanizma konkretë mbrojtës për të drejtat e njeriut? A ka mekanizma ligjorë mbrojtës që sanksionojnë cenimin e të drejtave nga IA dhe nëse jo cilat duhet të jenë ato? Këto pyetje, por edhe shumë të tjera do të gjejnë përgjigje përgjatë këtij punimi.

Fjalë kyç: inteligjencë artificiale, të drejtat e njeriut, instrumenta ligjorë, diskriminim, dinjitet njerëzor.

Roli i Inteligjencës Artificiale në Sport

Fatmir Pireva

Fatbardh Ajvazi

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: fatmir.pireva@aab-edu.net

Abstrakt

Teknologjitë e reja dhe aplikacionet kërkimore në fushën e Inteligjencës Artificiale kanë krijuar një revolucion të rëndësishëm në botën e sportit vitet e fundit. Sporti ka tërhequr gjithmonë vëmendje të madhe si një aktivitet i bazuar në maksimizimin e aftësive fizike të njerëzve dhe performancën në një mjedis konkurrues. Megjithatë, futja e Inteligjencës Artificiale në botën e sportit po ripërcakton rregullat e lojës dhe performancën e sportistëve. Konvergenca e Inteligjencës Artificiale dhe shkencës sportive jep avantazhe thelbësore në optimizimin e performancës së atletëve, zbutjen e rreziqeve të lëndimeve dhe përsosjen e strategjive të lojës. Qëllimi i këtij punimi është që të analizoj rolin e inteligjencës artificiale në sport duke u fokusuar në përdorimin e Inteligjencës Artificiale në monitorimin e afërt të lëvizjeve të atletëve, duke ofruar njohuri të vlefshme për të ndihmuar atletët të përmirësojnë teknikat dhe në analizën e të dhënave të mëdha, në identifikimin e parakushteve për të evituar lëndimet si dhe në analizat taktike individuale dhe ekipore. Punimi do të analizojë punimet e fundit të realizuara për të matë rolin e Inteligjencës Artificiale në këto tri aspekte. Nga hulumtime është konkluduar se platformat e ndryshme dhe aplikimi i teknologjisë së marrjes dhe përpunimit të të dhënave ka avancuar dukshëm analizën biomekanike si dhe performancën taktike të lojtarëve dhe ekipeve.

Fjalë kyç: inteligjencë artificiale, sport, biomekanikë, taktikë.

Aplikimi i inteligjencës artificiale në sistemin financiar: përfitimet dhe sfidat

Flori Miftari

Nakije Kida

Kolegji, AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: nakije.kida@universitetiaab.com

Abstrakt

Përparimet e shpejta në inovacionet teknologjike financiare, nisur nga kontabiliteti bazë deri te inteligjenca artificiale, historikisht kanë transformuar dhe ripërcaktuar funksionimin e shërbimeve financiare. Këto inovacione kanë rritur efikasitetin, kanë përmirësuar përfshirjen financiare, kanë lehtësuar shërbimin ndaj klientëve, kanë përmirësuar saktësinë në vendimmarrje dhe kanë reduktuar rreziqet në menaxhimin financiar. Mjetet kryesore të inteligjencës artificiale të aplikueshme në sektorin financiar si: vlerësimi i automatizuar i rrezikut dhe vlerësimi i kredive; zbulimi i mashtrimeve dhe siguria kibernetike; asistentët virtualë (Chatbots); tregtimi algoritmik; përfshirja financiare dhe zgjidhjet alternative bankare; si dhe teknologjia rregullatore (RegTech), luajnë një rol thelbësor në përmirësimin e shërbimeve financiare, zgjerimin e aksesit në financa dhe reduktimin e rreziqeve. Megjithatë, pavarësisht mundësive dhe përparësive të shumta, përdorimi i inteligjencës artificiale në sistemin financiar përballat me disa sfida dhe shqetësime. Çështjet më të rëndësishme përfshijnë mbrojtjen e privatësisë së të dhënave, sigurinë kibernetike, përputhshmërinë rregullatore, paragjykimet dhe kufizimet në zbatim, etj. Ky punim ofron një rishikim të zhvillimit dhe aplikimit të inteligjencës artificiale, duke identifikuar fushat kryesore ku mjetet e saj përdoren më së shumti në sistemin financiar. Për më tepër, punimi shqyrton ndikimet e aplikimit të AI, përfshirë efektet në burimet njerëzore, kostot financiare dhe kuadrin rregullator.

Fjalë kyç: inteligjenca artificiale, sistemi financiar, shërbimet financiare, përfshirja financiare.

Etika e medias dhe imazhet e krijuara nga media

Gazmend Abrashi

Xhevahire Izmaku

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

E-mail: xhevahire.izmaku@aab-edu.net

Abstrakt

Ndikimi i inteligjencës artificiale (AI) në shoqërinë njerëzore është i padiskutueshëm. Qëllimi i këtij punimi është të vëzhgojë ndikimin në industrinë e medias, veçanërisht ndikimin në kuptimin e plotë të efekteve artificiale dhe imazheve të integritit të AI në shumë dimensione të peizazhit mediatik. Rishikimi metodik i literaturës nxjerr në pah temat dhe idetë kryesore. Punimi shtjellon se si AI ka ndryshuar industrinë e medias duke përmirësuar krijimin dhe kurimin e përmbajtjes, dhe përmbajtjen vizuale, çështjet e privatësisë dhe etikën e medias. Rezultatet treguan se imazhi gjenerues është një mjet i fuqishëm krijues, por në evolucion të vazhdueshëm dhe kërkon që struktura ligjore të përdoret në mënyrë etike në media. Rezultatet nxjerrin në pah nevojën për udhëzime profesionale, teknika të përditësimit të aftësive dhe praktika etike të AI.

Fjalë kyç: media, etikë, AI, imazh, etikë mediatike.

Inteligjenca artificiale dhe mediat në Kosovë

Gentrita Xhemajli

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

gentrita2.xhemajli@universitetiaab.com

Abstrakt

Inteligjenca Artificiale (IA) ka filluar të luajë një rol të rëndësishëm në informimin e qytetarëve, duke mos lënë anash edhe ndikimin e saj në besueshmëri në media. Kjo temë ka për qëllim të informoj audiencën në lidhje me përdorimin e inteligjencës artificiale (IA) në media. Përdorimi i rrjeteve sociale ka shënuar rritje të madhe në të gjithë botën, duke bërë mediat online më të përdorura sesa mediat tradicionale. Qëllimi i këtij punimi është të tregojë se sa është i përdorur inteligjenca artificiale në mediumet e Kosovës? Pyetja kërkimore që shtrohet këtu është se nga cilat media po përdoret më së shumti inteligjenca artificiale? Dhe cilat lajme po janë të bëra me IA në mediat e Kosovës? Përmes analizimit të mediave, e veçanërisht ato të postuara më pas në mediat sociale, punimi konstaton se inteligjenca artificiale gjenë përdorim tek mediat e Kosovës, në veqanti ato digjitale. Ky punim tregon se cilat media siç janë: Portalet, Televizionet e njohura kosovare, përdorin inteligjencën artificiale në emisionet, kronikat televizive dhe lajmet e transmetuara në platformat e të tyre digjitale.

Fjalë kyç: lajme, inteligjenca artificiale, mediat, komunikimi

Sfidat e bizneseve kosovare përballë revolucionit të inteligjencës artificiale

Hana Gashi Ahmeti

Kolegji “Pjetër Budi”, Prishtinë, Kosovë

Email: hanagashi5@gmail.com

Abstrakt

Zhvillimi i shpejtë i teknologjive të inteligjencës artificiale (IA) në nivel global po ndryshon në mënyrë thelbësore terrenin konkurrues të biznesit bashkëkohor ndërkombëtar. Megjithëse IA sjell potencial të madh për inovacion, përmirësim të efikasitetit dhe vendimmarrje të bazuar në të dhëna, zbatimi i saj përballat me sfida të shumta – sidomos në vendet në zhvillim. Ky prezantim fokusohet në identifikimin e pengesave kryesore me të cilat përballen ndërmarrjet në Kosovë në përpjekjet e tyre për të integruar teknologjitë e IA-së në kuadër të transformimit dixhital. Duke u mbështetur në analiza cilësore dhe shembuj praktikë, hulumtimi pasqyron kufizimet strukturore, teknologjike dhe organizative që e ngadalësojnë përvetësimin e IA-së në sektorin privat të vendit. Ndër sfidat më të theksuara tek ndërmarrjet kosovare përmenden mungesa e aftësive teknike, qasja e kufizuar në infrastrukturën teknologjike të nevojshme, investimet ende të pamjaftueshme në drejtim të transformimit dixhital, si dhe niveli i ulët i ndërgjegjësimit për rëndësinë strategjike të inteligjencës artificiale. Për më tepër, mangësitë në politikat rregullative dhe mungesa e bashkëpunimit të qëndrueshëm mes institucioneve akademike, qeveritare dhe sektorit privat e bëjnë procesin e integritit edhe më sfidues. Megjithatë, pavarësisht këtyre vështirësive, studimi zbulon një rritje të interesit për IA-në nga ana e bizneseve kosovare dhe nënvizon nevojën për planifikim të qëndrueshëm strategjik, zhvillim të kapaciteteve dhe përkrahje institucionale për të lehtësuar tranzicionin dixhital.

Fjalë kyç: inteligjenca artificiale (IA), bizneset, revolucion, pengesat, zhvillimi

Aplikimi i AI-së (inteligjencës artificiale) dhe IoT (internet of things) në përpunimin e gjuhës natyrale në shërbim të komunitetit

Laurik Helshani

Burim Berisha

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: laurik.helshani@universitetiaab.com

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është ndërtimi i një pajisjeje interaktive që kombinon Raspberry Pi, një ekran me prekje (touchscreen) dhe algoritme të inteligjencës artificiale për të ofruar funksionalitetin text-to-speech. Pajisja synon të sigurojë një zgjidhje për përdoruesit që kanë nevojë për ndihmë zanore dhe ndërveprim më të avancuar me teknologjinë. Për të realizuar këtë projekt, pjesa harduerike përfshin përdorimin e një Raspberry Pi, i cili është i përshtatshëm për integrimin e komponentëve si një touchscreen, një modul zanor për përmirësimin e audios, dhe sensorë opsionalë për ndërveprime më të avancuara. Nga ana softuerike, Python do të përdoret për zhvillimin e aplikacionit që mundëson njohjen e tekstit dhe konvertimin e tij në të folur përmes teknologjive text-to-speech. Integrimi i inteligjencës artificiale në këtë sistem mundëson personalizimin e përvojës së përdoruesit, duke analizuar të dhënat dhe përmirësuar cilësinë e përgjigjeve zanore. Për shembull, modeli i AI-së mund të përshtatë intonacionin, të njohë komandat me një saktësi më të lartë dhe të mundësojë ndërveprime më natyrale. Kjo pajisje mund të përdoret në fusha të ndryshme si ndihmë për persona me aftësi të kufizuara, edukim interaktiv, automatizim i shërbimeve në kioska dixhitale apo asistentë zanorë të personalizuar. Përmes këtij punimi, do të analizohet procesi i ndërtimit të harduerit, zhvillimi i softuerit dhe optimizimi i tij për të siguruar performancë të lartë dhe përdorim të thjeshtë.

Fjalë kyç: IoT, text-to-speech, python, AI.

Roli i Teknologjisë në një domosdoshmëri për kalimin në sistem digjital dhe për të qëndruar konkurrues në treg

Liridon Buqa

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: liridon.buqa@universitetiaab.com

Abstrakt

Në epokën e transformimit dixhital, teknologjia ka bërë të domosdoshme kalimin e bizneseve në sisteme dixhitale për të qëndruar konkurrues në treg, më konkretisht bizneset e shitjes së produkteve për vetura në Kosovë. Ky studim eksploron rolin e teknologjisë si një faktor kyç në modernizimin e bizneseve, duke fokusuar në rastin e Kosovës. Nëpërmjet analizës së të dhënave dhe studimit të shembujve praktikë, hulumtimi zbulon se bizneset që investojnë në teknologji dhe adaptojnë sisteme dixhitale janë më të suksesshme në përmirësimin e efikasitetit operacional, zgjerimin e tregut dhe përmirësimin e përvojës së klientit. Studimi gjithashtu identifikon sfidat kryesore që bizneset në Kosovë përballin gjatë kalimit në dixhital, si mungesa e infrastrukturës, kufizimet financiare dhe nevoja për edukim teknologjik. Përfundimet e këtij studimi ofrojnë rekomandime për bizneset dhe politikatat publike për të nxitur transformimin dixhital dhe për të përmirësuar konkurrencën në treg.

Fjalë kyç: teknologjia, transformimi dixhital, konkurrueshmëria në treg, efikasiteti operacional, sfidat e transformimit dixhital të bizneseve.

Përdorimi i inteligjencës artificiale në gazetarinë ekonomike: mundësitë dhe rreziqet

Loreta Axhami

Universiteti i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

Email: loreta.axhami@fhf.edu.al

Abstrakt

Përdorimi i inteligjencës artificiale (AI) në gazetarinë ekonomike dhe të biznesit është rritur ndjeshëm në rang global duke ndikuar në shpejtësinë, cilësinë dhe saktësinë e raportimit. Ky zhvillim merr rëndësi të veçantë për vende si Shqipëria ku media përballet me një sërë sfidash jo vetëm të aspektit teknologjik por edhe financiar, menaxherial, etj. Në këtë kontekst, qëllimi i studimit është të analizojë nivelin e përdorimit të AI nga gazetarët shqiptarë që mbulojnë fushën e ekonomisë, biznesit dhe financës; ndikimin dhe qëllimin e përdorimit në punën e tyre si dhe perceptimet për të ardhmen e profesionit. Metodologjia e studimit bazohet në të dhëna sasiore të përfthuara nga pyetësorë të realizuar me gazetarë ekonomie të mediave të ndryshme të cilat ndërthuren me të dhëna cilësore të dala nga intervista të thelluara me studiues dhe ekspertë të fushës. Gjetjet e studimit tregojnë se përdorimi i AI është ende në fazën fillestare pasi vetëm një pjesë e vogël e gazetarëve e përdorin rregullisht në përditshmërinë e tyre ndërsa shumica e përdorin në mënyrë sporadike kryesisht për kërkim/përmbledhje informacioni, redaktim teksti apo analiza financiare. Gazetarët vlerësojnë se teknologjia ka përmirësuar cilësinë e raportimit por shqetësim kryesor mbetet mungesa e saktësisë së informacionit të gjeneruar nga AI, çka çënon besueshmërinë dhe ngre pikëpyetje mbi etikën e përdorimit të kësaj teknologjie të re në gazetari. Rezultatet e studimit shtrojnë nevojën për trajnime të gazetarëve për përdorimin e inteligjencës artificiale në mënyrë që jo vetëm të maksimizohen përfitimet por edhe të identifikohen e zvogëlohen rreziqet nga shfrytëzimi i saj.

Fjalë kyç: Inteligjenca artificiale (AI), gazetaria ekonomike dhe e biznesit, analiza financiare, cilësi informacioni, besueshmëri, etikë.

Aplikimi i Inteligjencës Artificiale në Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme në Republikën e Kosovës

Lulzim Shabani

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: lulzim.shabani@universitetiaab.com

Abstrakt

Inteligjenca artificiale si ide ekziston për shumë vite, por zhvillimi i saj domethënës sapo ka filluar. Përdorimi i inteligjencës artificiale po rritet si në jetën e përditshme po ashtu dhe në biznes. Duke marrë parasysh rëndësinë e aplikimit të inteligjencës artificiale në biznesin e sotëm, ky punim ka eksploruar aplikimin dhe sfidat e saj në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në Republikën e Kosovës. Prandaj qëllimi i këtij punimi është të tregojë arsyet dhe metodat për aplikimin e inteligjencës artificiale në operacionet e biznesit. Bazuar në një studim të realizuar në mesin e 70 ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme në Republikën e Kosovës, ky hulumtim synon të përcaktojë rëndësinë e aplikimit të inteligjencës artificiale në sektorin e biznesit dhe të analizojë mundësitë që ofron kjo teknologji për zhvillimin dhe rritjen e tyre. Objektivi i dytë i këtij studimi është vlerësimi i nivelit të kënaqshmërisë së kompanive që tashmë kanë integruar inteligjencën artificiale në aktivitetet e tyre. Rezultatet e analizës empirike treguan se të gjitha kompanitë e përfshira në studim përdorin të paktën një formë të inteligjencës artificiale në proceset e tyre të biznesit. Përfitimet kryesore që ato identifikojnë lidhen me kursimin e kohës dhe burimeve, rritjen e efikasitetit operacional si dhe përmirësimin e proceseve të prodhimit dhe ofrimit të shërbimeve. Këto gjetje dëshmojnë për rëndësinë e rritjes së ndërgjegjësimit dhe investimeve në këtë fushë, duke e konsideruar inteligjencën artificiale një faktor kyç për zhvillimin e mëtejshëm të bizneseve në Kosovë.

Fjalë kyç: inteligjenca artificiale (IA), aplikimi, mundësitë, proceset ndërmarrjet e vogla dhe të mesme,

Përdorimi i ChatGPT për Korrigjimin e Teksteve nga Gazetarët: Përfitimet, Kufizimet dhe Rreziqet

Marsela Shytia

Universiteti i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

Email: marselashytia@gmail.com

Abstrakti

Përdorimi i Inteligjencës Artificiale dhe ChatGPT si aplikacioni më popullor, nga gazetarët në punën e tyre të përditshme po bëhet gjithnjë e më i zakonshëm. Edhe në mediat shqiptare, përdoret gjerësisht, kryesisht për të redaktuar tekste dhe për të korrigjuar gabimet drejtshkrimore. Ky punim synon të evidentojë përfitimet e kësaj praktike dhe nga ana tjetër të nxjerrë në pah edhe kufizimet dhe rreziqet që vijnë bashkë me to. Përmes një qasjeje kualitative, do të analizohet përdorimin e ChatGPT nga gazetarët shqiptarë për korrigjimin e teksteve. Metoda kryesore e mbledhjes së të dhënave do të jetë intervista me gazetarë që punojnë në media të ndryshme, duke përfshirë gazeta të shtypura si “SOT” dhe “Fjala” si dhe portale online si Konica.al. Nga njëra anë, gazetarët tani kanë mundësi të ekonomizojnë kohën e tyre me redaktimin automatik, duke mos pasur më nevojë për një redaktor në strukturat e tyre. Nga ana tjetër, të intervistuarit pohojnë se gjuha shqipe ka struktura dhe forma gramatikore të ndërlikuara që mund të jenë të vështira për ChatGPT, duke shkaktuar mundësi gabimesh. Gjithashtu ata tregojnë se përdorimi i Inteligjencës Artificiale krijon një lloj “varësie”. Në përfundim, përdorimi i ChatGPT për korrigjimin e teksteve gazetareske ofron përfitime si rritja e saktësisë dhe shpejtësia në redaktim. Megjithatë, duhet të jemi të vetëdijshëm se mund të çojë në humbjen e aftësive manuale të redaktimit të gazetarëve. Prandaj, është thelbësore që ChatGPT të përdoret si një mjet ndihmës, jo si një zëvendësues i redaktorëve.

Fjalë kyç: Inteligjenca Artificiale, ChatGPT, media shqiptare, gazetarë, redaktim, korrigjim.

Inteligjenca Artificiale në Edukim

Mentor Rrustemaj

Sh.F.M.U " 8 Dëshmorët ", Gjakovë, Kosovë

Email: mentor.rrustemaj@gmail.com

Abstrakt

Zhvillimi i shpejtë i Inteligjencës Artificiale, është duke luajtur një ndikim madhështorë mbi edukimin. Duke e filluar me këtë thënje nga Asistentja e Drejtorit Gjeneral pranë UNESCO-s, do të shohim disa të dhëna në botë rreth përdorimit të teknologjisë AI në sistemin e Arsimit në përgjithësi. Për këtë punim janë përfshirë të dhëna të ndryshme ndërkombëtare - duke përfshirë, ueb faqe të ndryshme, Revista Ndërkombëtare mbi edukimin, raporte të BE-së dhe ato nga SHBA-të, e deri tek Organizata Botërore për Ruajtjen e Trashëgimisë Kulturore (UNESCO). Në këtë punim, së pari, bëhet fjalë për historiatin e AI-së, më pas përfshirjen e AI-së në edukim - në procesin e mësimdhënies dhe nxënies, duke mos anashkaluar versionet e CHATGPT-së (versionet 3.0, 3.5 dhe 4.0). Për transformimin e edukimit në kuadër të teknologjisë AI, pastaj për aplikacione dhe platforma (20 sosh), të cilat, duke e shfrytëzuar AI-në, përdoren në sistemin e edukimit - duke theksuar rendësit e tyre në përgjithësi. Si e rëndësishme, dhe ku është përfshirë në këtë punim, është edhe sfida e përdorimit të AI-së në procesin e edukimit si dhe aspektin e etikës, sa i përket përdorimit të AI-së në procesin edukativ. Në fund fare ky punim përfundon me disa rekomandime, gjithnjë duke u bazuar në të gjeturat nga të dhënat e dokumentacionit të lartcekur, dhe me bindjen së puna e bërë do të ofron të dhëna të rëndësishme në këtë drejtim.

Fjalë kyç: Inteligjenca artificiale, ChatGpt, mësimdhënie, mësimnxënie, rekomandime.

Përparimet në inteligjencën artificiale dhe robotikë: ndikimi mbi produktivitetin dhe adoptimi i teknologjisë në NVM-të e Ballkanit Perëndimor

Mimoza Maloku

Kolegji AAB, Prishtinë

mimoza.maloku@universitetiaab.com

Abstrakt

Përparimet e shpejta në inteligjencën artificiale (AI) dhe robotikë kanë shkaktuar shqetësime lidhur me ndikimin e mundshëm të këtyre teknologjive mbi produktivitetin në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (SMEs) në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Një nga shqetësimet kryesore është mundësia e zhvendosjes së forcës së punës, që kërkon një adaptim psikologjik ndaj këtyre teknologjive. Megjithatë, adoptimi i AI-së në SMEs mund të sjellë përfitime të shumta, përfshirë përmirësimin e performancës financiare, rritjen e angazhimit të punonjësve, menaxhimin efikas të të dhënave dhe strategji të avancuara marketingu, siç theksohet nga Kumar dhe Kalse. Rëndësia e adoptimit të AI për SMEs u theksua gjatë sfidave të shkaktuara nga pandemia e COVID-19. Ky hulumtim shqyrton ndikimin e AI dhe robotikës në SMEs në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke u përqendruar në ndryshimet psikologjike të nevojshme për punonjësit dhe rezultatet ekonomike të lidhura me adoptimin e teknologjive. Ky studim synon të vlerësojë nivelin aktual të integritit të AI dhe robotikës në SMEs në Ballkanin Perëndimor, duke shqyrtuar sfidat që hasin këto ndërmarrje gjatë adoptimit të këtyre teknologjive.

Fjalë kyç: AI, robotikë, produktivitet, adoptim i teknologjisë, adaptim psikologjik, Ballkan Perëndimor

Fjalët e tepërta në masmedia dhe roli i teknologjisë digjitale në korrigjimin e gabimeve sintaksore

Naile Demiri

Bujar Tafa

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: bujar.tafa@universitetiaab.com

Abstrakt

Në këtë parashtrësë mëtoj të vej në dukje disa nga fjalët e tepërta në fjali, të cilat, jo gjithherë po përdoren drejt e mirë, si për shkak të një “jo profesionalizmi shkencor-sintaksor” me rastin e përdorimit të tyre në ligjërimin e lidhur (në formën e folur e të shkruar), ashtu edhe për shkak të një papërgjegjësie që e ndeshim në masmedia dhe te të gjitha shtresat shoqërore në profesionet që ushtrojmë. Në ditët e sotme kur ndikimi i masmedias është më i madh se kurrë, përdorimi i fjalëve dhe i shprehjeve të tepërta në fjali e periudhë, bien ndesh me kërkesat e një shkrimi të thuktë e të qartë, ndesh një ekonomizimi gjuhësor, e që për këtë na mëson një fjali e famshme e filozofit francez Paskal, në një nga letrat e tij: “E kam bërë këtë letër më të gjatë se zakonisht, sepse nuk kisha kohë ta bëja më të shkurtër”. Objekti kryesor i këtij studimi është të identifikoj këto gabime (teprinë e fjalëve e të shprehjeve në fjali) në masmediat tona dhe të vlerësoj ndikimin që ato kanë në strukturën e fjalive dhe të qartësisë së mesazhit. Po ashtu, punimi im synon të vejë në pah rolin e teknologjive digjitale, si p.sh., ChatGPT, në korrigjimin e strukturës sintaksore të fjalive dhe mundësinë e mënjanimin të fjalëve e shprehjeve të tepërta në fjali e periudha, me qëllim për të kontribuar një gjuhë më funksionale, si te masmediat, e gjithsesi edhe në të mësuarit e gjuhës shqipe drejt e mirë në të folur e në të shkruar.

Fjalë kyç: fjalë, shprehje, fjali, masmedia, thuktësia e fjalisë, teknologjia digjitale, ChatGPT.

Gjuhësia përballë teknologjisë

Orjeta Dushi ¹

Blerina Lera ²

Email: blerinakola84@gmail.com

¹ Universiteti i Shkodrës, Shqipëri

² Gjimnazi “28 Nëntori”, Shkodër, Shqipëri

Abstrakt

Gjuhësia, shkencë në përdorim dhe në studim, realizohet nëpërmjet kodimit dhe dekodimit të informacionit momental, ose afatgjatë. Rijetësimi i gjuhës në komunikimin human dhe gërshetimi me algoritmet e AI-së është qëllimi i këtij studimi. Duke përdorur metodat përshkruese e shpjeguese, bazuar në literaturë të pasur kemi arritur rezultatet: 1. Pasqyrimin e programeve, metodave e mjeteve që lehtësojnë rezultatin e kërkimit shkencor në një saktësi matematikore e shpejtësi kohore në studimin e teksteve të autorëve të vjetër për stilin e tyre, për përdorimin e shpeshtë ose jo të klasave të fjalëve/ lemeve. 2. Sfidën e kohës me përshtatjen e programeve mësimore në përputhje me botën e automatizuar duke ekonomizuar komunikimin gjuhësor me anë të fjalëve kyçe. 3. Format e edukimit të studentëve drejt të menduarit kritik duke përdorur AI-në në mënyrë etike. Përdorimi i rezultateve sjell: a) risi për ndryshimin e kurrikulave mësimore; b) metoda të edukimit drejt të menduarit kritik larg plagjiaturës; c) integrimin e shoqërisë humane në përdorimin e teknologjisë. Mesazhi ynë: Përdor rrjetëzimin, të fitosh civilizimin!

Fjalë kyç: komunikim, tekst, program, metoda, edukim, mendim kritik.

Transformimi i kontabilitetit përmes inteligjencës artificiale: rishikim sistematik i literaturës mbi rolin e edukimit dhe kërkesat e tregut të punës

Pranvera Dalloshi

Nderim Rexhepi

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: pranvera.dalloshi@universitetiaab.com

Abstrakt

Inteligjenca artificiale po revolucionarizon gjithnjë e më shumë profesione të fushave të ndryshme, përfshirë edhe kontabilitetin dhe auditimin. Ndërkaq, në përballje me këtë ndryshim, universitetet luajnë një rol thelbësor në përgatitjen e kontabilistëve të ardhshëm për të përballuar sfidat dhe transformimet e tregut të punës. Ky punim analizon ndikimin e inteligjencës artificiale (AI) në profesionin e kontabilitetit përmes një rishikimi sistematik të literaturës, duke u fokusuar në dy dimensione thelbësore: perceptimet e studentëve të kontabilitetit mbi përgatitjen e tyre për sfidat që sjell AI dhe kërkesat e industrisë për kompetenca të reja digjitale. Duke aplikuar metodologjinë e rishikimit sistematik sipas qasjes së Kitchenham (2004), janë përzgjedhur dhe analizuar studime të publikuara gjatë periudhës 2015–2025 nga burime akademike të besueshme. Gjetjet tregojnë një mospërputhje të theksuar midis aftësive të vetëvlerësuar të studentëve dhe pritshmërive të tregut të punës, duke theksuar nevojën për reformë në kurrikulat universitare. Po ashtu, studimet nxjerrin në pah rëndësinë e angazhimit aktiv të profesionistëve me teknologjinë dhe integrimin e AI në praktikat kontabël dhe auditim. Kjo nënkupton se kontabilistët duhet të kuptojnë dhe interpretojnë teknologjinë, të zhvillojnë aftësi në analizën e të dhënave, shkrim-leximin në AI dhe mjete digjitale, ndërsa zhvendosen drejt roleve strategjike si analiza e biznesit, qëndrueshmëria dhe etika e AI. Punimi rekomandon që institucionet e arsimit të lartë të zhvillojnë programe të përshtatshme të kontabilitetit.

Fjalë kyç: Inteligjenca Artificiale (AI), kontabiliteti, kërkesat e tregut të punës.

Inteligjenca Artificiale dhe Politikat Publike në Kosovë: Mundësitë dhe Sfidat për Barazi Sociale

Pranvera Jusufi Imeri

South East European University (SEEU), North Macedonia

Email: pj33253@seeu.edu.mk

Abstrakt

Inteligjenca Artificiale po luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik dhe social të Kosovës. Zbatimi i saj në sektorë të ndryshëm, si arsimi, shëndetësia dhe administrata publike ofron mundësi të rëndësishme për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve dhe rritjen e efikasitetit operativ. Megjithatë, mungesa e një kuadri strategjik të qartë, e kombinuar me rreziqet e thellimit të pabarazisë sociale, mund ta zgjerojë hendekun ekonomik dhe dixhital në vend. Ky studim synon të analizojë ndikimin e IA në barazinë sociale në Kosovë dhe të propozojë politika që promovojnë një qasje gjithëpërfshirëse ndaj avancimit teknologjik. Metodologjia përfshin një analizë të gjerë të të dhënave dytësore, duke përfshirë raporte institucionale dhe praktikat më të mira ndërkombëtare mbi ndikimet shoqërore të IA. Rezultatet tregojnë se, pa një kuadër rregullator efektiv, rritja e përdorimit të IA mund të thellojë pabarazitë ekzistuese, veçanërisht për komunitetet e marginalizuara. Sidoqoftë, politikat e hartuara mirë mund ta shfrytëzojnë IA-në për zhvillim të qëndrueshëm dhe krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët. Në përfundim, ekziston një nevojë urgjente për një strategji të integruar që garanton qasje të barabartë në teknologji, promovon transparencën në aplikimin e IA dhe krijon një kuadër etik për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve. Me masat e duhura, IA mund të bëhet një mjet jetik për ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse në Kosovë.

Fjalë kyç: inteligjenca artificiale (IA), politikat sociale, barazia, pabarazia, Kosova

Literacia e inteligjencës artificiale në redaksitë mediatike shqiptare dhe sfida e aplikimit

Raimonda Nelku

Universiteti i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

Email: raimonda.nelku@fhf.edu.al

Abstrakt

Zhvillimet në media kudo në botë kanë sjellë një ekspozim të shtuar ndaj Inteligjencës Artificiale (IA në redaksi, duke rritur efikasitetin në punë. Detyrat që IA përmbush në praktikë janë rutinë e thjeshtë dhe e përsëritshme. Kësisoj që ajo ti përgjigjet kërkesave të gazetarisë duhet të programohet, në mënyrë që ti përshtatet nevoja editoriale të redaksisë së lajmeve. Por si ka ndikuar IA në redaksitë shqiptare, deri në cilën masë ato kanë njohuri, janë familjarizuar dhe e përdorin atë ? Ky studim synon të vlerësojë nivelin e literacisë dhe gatishmërinë e redaksive shqiptare, përfshirë televizionet kombëtare dhe rajonale, si dhe mediat online, për t'u përshtatur me këto transformime teknologjike. Hulumtimi bazohet në një analizë empirike me të dhëna të dorës së parë të mbledhura me gazetarë dhe redaktorë të angazhuar në media të ndryshme. Ndërsa shumë përdorime të IA mund ti shërbejnë interesit publik, nevoja për ekspertizë mbi efektet e saj mbetet një sfidë e hapur për gazetarinë moderne. Gjetjet e punimit tregojnë se adoptimi i IA në mediat shqiptare është ende në fazat e hershme, me përdorime të kufizuara të redaksive. Ky studim thekson nevojën për një qasje më të strukturuar ndaj integritit të IA në redaksitë shqiptare, përmes investimeve në edukim, teknologji si dhe strategji për të balancuar automatizimin me ruajtjen e rolit njerëzor në gazetari.

Fjalë kyçe: inteligjencë artificiale, literaci, redaksi, media shqiptare

Dilemat etike në përdorimin e IA-së

Ridvan Emini

Universiteti i Evropës Juglindore, Maqedonia e Veriut

Email: re29788@seeu.edu.mk

Abstrakt

Një nga dilemat etike më të mëdha në kohën bashkëkohore është përdorimi i Inteligjencës Artificiale (IA) në vendimmarrje pasi që shumë filozof të etikës konsiderojnë se algoritmet që përdoren mund të dërgojnë në vendime të gabuara, rrjedhimisht mund edhe të rrisin dozën e paragjykitimit dhe diskriminimit. Krejt kjo sipas këtyre mendimtarëve mund të dërgoj në pabarazi edhe më të mëdha në shoqëri. Sipas filozofëve të moralit, përdorimi i IA-së sidomos në rastet e vendimmarrjes në fushën e drejtësisë, politikës, mediave etj., duhet ti përmbajë pyetjet esenciale se algoritmet që përdoren në teknologji a janë të ndershme apo sa janë të tilla?, A përforcon paragjykimet ekzistuese IA?. A kanë përgjegjësi krijuesit e IA-së dhe cila mund të jetë ajo? Një dilemë tjetër e filozofëve është edhe emancipimi shoqëror përmes IA-së. Pra, sa mund të jenë të dobishme për shoqërinë këto sisteme teknologjike. Sfidë në 'epokën digjitale' për filozofët e moralit mbetet edhe përdorimi i IA-së për mbikëqyrje, përkatësisht ata kërkojnë që të avancohen rregulloret/udhëzimet dhe ligjet që mbrojnë të drejtat dhe liritë e individit përkatësisht njeriut.

Fjalë kyç: IA, vendimmarrje, paragjykim, pabarazi, etika, përgjegjësi, mbikëqyrje.

Integrimi i Inteligjencës Artificiale në Strategjitë e Bizneseve Kosovare

Rrezarta Gashi

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: rezartag@gmail.com

Abstrakt

Inteligjenca artificiale (IA) tashmë është duke luajtur një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në transformimin e të bërit biznes në nivel global, duke ndikuar në mënyrën se si ndërmarrjet operojnë, marrin vendime dhe ndërveprojnë me klientët dhe tregun operues. Ky prezantim shqyrton procesin e integritit të IA në strategjitë e bizneseve kosovare, me qëllim identifikimin e tendencave të adoptimit, fushave prioritare të aplikimit dhe sfidave kryesore që shoqërojnë këtë transformim. Studimi bazohet në një qasje të kombinuar kërkimore, duke përfshirë analizën empirike të praktikave vendore si dhe krahasimin me përvoja ndërkombëtare të suksesshme. Fokus i veçantë i analizës janë përfitimet strategjike të IA në sektorët kyç të ekonomisë kosovare – përfshirë automatizimin e proceseve, personalizimin e shërbimeve dhe zhvillimin e produkteve inovative. Gjetjet e paraqitura tregojnë se bizneset që integrojnë IA në mënyrë të qëllimshme dhe të planifikuar kanë potencial të rrisin ndjeshëm efikasitetin, konkurrueshmërinë dhe qëndrueshmërinë në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare. Megjithatë, përballja me mungesën e aftësive teknike, infrastrukturës digjitale të përshtatshme dhe kapaciteteve strategjike të menaxhimit mbetet një sfidë thelbësore, që kërkon mbështetje të koordinuar nga sektori publik, privat dhe akademik.

Fjalë kyç: inteligjenca artificiale (IA), bizneset, planet strategjike, zhvillimet, mundësitë.

Roli i inteligjencës artificiale në mbrojtjen e infrastrukturave kritike

Samir Jakupi

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: samir.jakupi@universitetiaab.com

Abstrakt

Në epokën tonë infrastrukturat si: Energjia, Uji, Transporti dhe Sistemet Shëndetësore, kanë infrastruktura të digjitalizuar dhe janë të ndërlidhura me sistemet dixhitale të komunikimit. Dixhitalizimi i këtyre infrastrukturave ka shumë të mira po gjithashtu i bënë më të hapura ndaj sulmeve kibernetike duke rrezikuar sigurinë kombëtare dhe mirëqenien publike. Në këtë studim do të analizohet roli i Inteligjencës artificiale (AI) në mbrojtjen e këtyre infrastrukturave shumë të rëndësishme, me fokus të veçantë në zbulimin proaktiv të anomalive, parandalimin e sulmeve dhe reagimi në kohë sa më të shpejt. Në këtë studim do të shqyrtohen literature aktuale dhe softuer/pajisje të cilat përdorin inteligjencën artificiale për mbrojtje ndaj sulmeve kibernetike. Shumë studime tregojnë se me përdorimin e AI mund të zvogëlohet koha e reagimit ndaj kërcënimeve kibernetike duke shmangur ndërprerjet totale të shërbimeve. Për të pasur sukses në implementimin e këtyre teknologjive të fundit duhen politika te qarta sigurie, staf i trajnuar dhe bashkëpunim ndërinstitucional.

Fjalë kyç: inteligjencë artificiale, infrastrukturë kritike, siguri kibernetike, parandalim sulmesh, mbrojtje dixhitale.

Projekti Reconnected në Kosovë: aplikimi i IA përmes të mësuarit përforcues për shëndetin mendor

Sevim Mustafa¹, Naim Fanaj^{2,4}, Elona Krasniqi^{3,4}

¹ Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

² Alma Mater Europae Campus College Rezonanca, Prishtinë, Kosovë

³ Kolegji UBT, Prishtinë, Kosovë

Email: naimfanaj@gmail.com

Abstrakt

Projekti RECONNECTED, i mbështetur nga programi BE/Horizon Europe, synon të trajtojë çështjet e shëndetit mendor të përjetuara nga popullatat e cenueshme në Evropë, duke përfshirë ato në Kosovë, veçanërisht individët me status të ulët socio-ekonomik. Objektivi është të prezantohet aplikimi Inteligjencës Artificiale përmes të mësuarit përforcues për shëndetin mendor në kuadër të projektit RECONNECTED. Do të bëhet përshkrimi i mënyrës së përdorimit të IA në projekt dhe rishikimi i literaturës në lidhje me të mësuarit përforcues në shëndetin mendor. Mësimi përforcues (RL) po eksplorohet gjithnjë e më shumë për aplikime në shëndetin mendor (terapitë e personalizuara, planet e trajtimit, monitorimin dhe ndërhyrjet e hershme etj). Projekti RECONNECTED përdorë Mikro-ndërhyrjet përmes aplikacionit Moodbuster. Këto bazohen në paradigmen e Të mësuarit përforcues përmes të teknikës së Mësimi përmes makinerisë. Vendimmarrja sekuenciale e kësaj teknike do vendos cilat aktivitete ose mikrondërhyrje ti ofrohen, kohën e përshtatshme, metodën se si ti ofrohen, për përkujtuesit, ndjenjat etj. Kjo do mundëson personalizimin e aktiviteteve më të mira të përdoruesve. RECONNECTED synon që ta zbatoj në praktikë paradigmen e suksesshme të të mësuarit përforcues e cila përshtatet shumë natyrshëm me algoritmet e personalizimit në kujdesin për shëndetin mendor.

Fjalë kyç: RECONNECTED, IA, të mësuarit përforcues, shëndeti mendor, Kosovë.

Ndikimi i marketingut digjital në sjelljen e konsumatorëve: roli i chatbot-eve, sponsorizimeve dhe influencersve

Shaip Bytyçi

Vjollca Hasani

Gazmend Abrashi

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: vjollca.hasani@universitetiaab.com

Abstrakt

Marketingu digjital ka transformuar mënyrën se si konsumatorët marrin vendime për blerje, duke e bërë ndërveprimin me markat më të personalizuar dhe më të drejtpërdrejtë. Ky studim analizon ndikimin e tre faktorëve kryesorë të marketingut digjital – chatbot-ët, sponsorizimet dhe influencersit – në sjelljen e konsumatorëve. Me avancimet në inteligjencën artificiale, chatbot-ët janë shndërruar në mjete të rëndësishme për ofrimin e shërbimit ndaj klientit, duke ndikuar në besnikërinë dhe përvojën e konsumatorit. Në të njëjtën kohë, sponsorizimet po zëvendësojnë reklamën tradicionale si një mënyrë më efektive për të ndikuar në perceptimin e markës dhe për të rritur angazhimin e klientëve. Për më tepër, marketingu me ndikim ka fituar rëndësi të madhe, me influencersit që luajnë një rol kyç në formimin e opinioneve dhe vendimeve të blerjes përmes mediave sociale. Studimi shqyrton se cili prej këtyre faktorëve ka ndikimin më të madh në sjelljen e konsumatorëve, duke ofruar një perspektivë të re mbi ndryshimet e tregut dhe tendencat e reja të marketingut digjital. Rezultatet e hulumtimit pritet të kontribuojnë në zhvillimin e strategjive më efektive për bizneset që synojnë të maksimizojnë ndikimin e tyre në konsumatorët modernë.

Fjalë kyç: marketingu digjital, sjellje konsumatore, Chatbot-e, sponsorizim, influencers.

Integrimi i Inteligjencës Artificiale në Edukimin Fizikë

Shemsedin Vehapi

Besim Gashi

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: besim.gashi@aab-edu.net

Abstrakt

Edukimi fizik është një disiplinë e rëndësishme shkollore e cila luan rolë të rëndësishëm në zhvillimin e personalitetit të fëmijëve. Përdorimi i teknologjisë dhe inteligjencës artificiale në procesin edukativ kohëve të fundit është identifikuar si një mënyrë për të përmirësuar përmbajtjen arsimore e cila ka prodhuar ndryshime domethënëse krahasuar me modelet klasike arsimore. Inteligjenca Artificiale avancoi komunikimin mesimdhënës-mësimnxënës, duke mundësuar përpunimi dhe transmetimin e informacion në mënyrë të menjëhershme, efikase të thjeshtë dhe kuptimplote. Qëllimi i këtij punimi është që të analizoj dhe bëjë një rishikim të literaturës shkencore mbi inteligjencën artificiale dhe se si ajo mund të mbështesë mesimdhënësin e edukimit fizik në procesin e mesimdhënies në veçanti në disajnimin e materialit mesimorë dhe transmetimit të drejtpërdrejt të informacioneve, në përmirësimin e aspekteve organizative të orës mesimore, rritjen e motivimit dhe përmirësimin e klimës në mesim si dhe organizmin e detyrave jashtëshkollore mbi bazën e planeve të personalizuar të bazuar në nevojat dhe preferencat e fëmijëve. Hulumtimet tregojnë se platformat e ndryshme teknologjike dhe përdorimi i Inteligjencës Artificiale kanë ndihmuar mesimdhënësit e edukimit fizikë në rritjen e efikasitetit të punës si dhe kanë ngritur nivelin e përfshirjes aktive të fëmijëve në aktivitet fizike në shkollë dhe në detyrat jashtë shkollës.

Fjalë kyç: inteligjencë artificiale (IA), edukim fizikë, shkollë, ora mesimore.

Jetesa familjare në kohën e inteligjencës artificiale: ndërmjet komoditetit dhe sfida etike

Violeta Smajlaj

Fakulteti i Studimeve Islame, Prishtinë, Kosovë

Email: violetasmajlaj4@gmail.com

Abstrakt

Epoka e inteligjencës artificiale (IA) që tashmë është shtrirë gjithandej, po transformon rrënjësisht mënyrën se si familjet funksionojnë dhe ndërveprojnë në përditshmëri. Ky punim ka për qëllim të vë në pah ndikimin e inteligjencës artificiale, duke vënë theksin te balanca mes përfitimeve praktike dhe implikimeve etike. Inteligjenca artificiale tashmë ka ndryshuar edhe stilin e jetës, duke futur komoditet të ri në jetën familjare përmes pajisjeve të zgjuara. Megjithatë, këto zhvillime kanë hapur dilema të rëndësishme etike, përfshirë cenimin e privatësisë, ndryshimin e dinamikave ndërpersonale, rrezikun e varësisë nga teknologjia, si dhe sfidat etike duke bërë që kjo e fundit të pësojë disa ndryshime. Ky studim përfshinë një qasje ndërdisiplinore, duke integruar perspektiva nga fusha të ndryshme, si: sociologjia, teknologjia dhe etika, për të analizuar se si IA ndikon në strukturën dhe marrëdhëniet brenda familjes. Rezultatet synojnë të pasqyrojnë jo vetëm përfitimet që IA mund të sjellë, por edhe sfidat që kërkojnë trajtim të kujdesshëm dhe të detajuar. Punimi përpiqet të nxisë një debat të ndërgjegjshëm për përdorimin e teknologjisë në jetën familjare, duke propozuar qasje të balancuara që mund të ndihmojnë familjet të përfitojnë nga IA pa rrezikuar vlerat dhe mirëqenien e tyre.

Fjalë kyç: Inteligjenca artificiale, familja, etika, sfidat, jetesa familjare

Një analizë e shfrytëzimit të ChatGPT në lëndët *Gjeometri deskriptive* dhe *Algjebër lineare*

Vjollca Mustafa

Universiteti i Evropës Juglindore, Republika e Maqedonisë së Veriut

Email: v.mustafa@seeu.edu.mk

Abstrakt

Ndërsa studentët shfrytëzojnë ChatGPT për përgjigje të shpejta dhe për zgjidhjen e detyrave pa u munduar shumë, kjo teknologji ofron edhe më shumë lehtësira dhe kursim kohe për profesorët gjatë përgatitjes së detyrave dhe punimeve të ndryshme. Megjithatë, besueshmëria e informacionit dhe të dhënave të marra nga ChatGPT dhe mjete të tjera të ngjashme mbetet për t'u verifikuar. Në punimin tim kam shqyrtuar disa shembuj konkretë mbi zgjidhjen dhe formulimin e detyrave në lëndët Algjebër Lineare dhe Gjeometri Deskriptive. Arsyeja pse u përqendrova te këto dy lëndë është se, gjatë testimeve me pyetje në ChatGPT për detyra nga Algjebra Lineare, kam vërejtur se shumica e rezultateve janë të sakta. Ndërsa, për Gjeometrinë Deskriptive, modeli ofron kryesisht vizatime hapësinore dhe aksiometri, por jo projeksione ortogonale, të cilat janë të domosdoshme gjatë orëve mësimore dhe për t'u shfrytëzuar nga studentët. Mund të themi se inteligjenca artificiale paraqet një "kuti të Pandorës" me mundësi të pafundme.

Fjalë kyç: ChatGPT, gjeometri deskriptive, algjebër lineare.

Aplikimi i teknologjisë *Blockchain* në ciklin e kontabilitetit dhe raportim financiar: mundësitë dhe sfidat

Ylber Prekazi

Kolegji AAB, Prishtinë, Kosovë

Email: ylber.prekazi@universitetiaab.com

Abstract

Teknologjia Blockchain ka sjellë ndryshime të mëdha në fusha të ndryshme, përfshirë edhe kontabilitetin dhe raportimin financiar. Ky punim shqyrton aplikueshmërinë e kësaj teknologjie në ciklin e kontabilitetit, duke analizuar avantazhet, sfidat dhe ndikimet e mundshme në proceset tradicionale të regjistrimit dhe raportimit financiar. Përmes një qasjeje teorike dhe praktike, studimi eksploron se si blockchain mund të përmirësojë transparencën, sigurinë dhe efikasitetin e transaksioneve kontabël. Gjithashtu, diskutohen ndikimet e mundshme në rolin e kontabilistëve dhe audituesve, si dhe adaptimi i standardeve ekzistuese kontabël dhe të raportimit financiar ndaj kësaj teknologjie inovative. Rezultatet e studimit tregojnë se blockchain ka potencialin të transformojë ciklin kontabël, por kërkon gjithashtu sfida rregullatore dhe teknike që duhet të adresohen përpara implementimit të plotë. Studimi, po ashtu tregoi se zbatimi i teknologjisë blockchain e plotëson ciklin normal të kontabilitetit, duke ofruar kursime në kosto, identitet dixhital dhe siguri të shtuar.

Fjalë kyç: teknologjia Blockchain, kontabiliteti, raportimi financiar, transparenca, auditimi, siguria financiare.

Kufiri midis ndihmës dhe varësisë: përdorimi i ChatGPT nga gazetarët për korrigjimin e teksteve në Shqipëri

Danjela Barçi

Departamenti i Gazetarisë, Universiteti i Tiranës, Shqipëri

Email: danjelabarci@gmail.com

Abstrakt

Zhvillimi i inteligjencës artificiale dhe integrimi i saj në fushën e medias ka sjellë ndryshime të dukshme në mënyrën se si gazetarët punojnë dhe redaktojnë tekstet. Përdorimi i ChatGPT nga gazetarët për korrigjimin dhe redaktimin e teksteve është bërë një praktikë në rritje, duke sjellë përfitime të prekshme në aspektin e efikasitetit, cilësisë gjuhësore dhe kursimit të kohës. Ky punim analizon se si ChatGPT mund të ndihmojë në përmirësimin e strukturës së fjalive, korrigjimin e gabimeve drejtshkrimore, pasurimin leksikor dhe në disa raste, ofrimin e versioneve më të rrjedhshme të një teksti. Megjithatë, përdorimi i këtij mjeti nuk është pa kufizime. Përdorimi i ChatGPT në gazetari mund të deformojë mesazhin origjinal për shkak të mungesës së kuptimit të kontekstit, ndjeshmërisë kulturore dhe stilit personal, duke rrezikuar gjithashtu zbehjen e mendimit kritik dhe përhapjen e informacionit të pasaktë. Gjithashtu, përdorimi i AI-së pa transparencë mund të ngrejë shqetësime etike, veçanërisht në rastet kur publikut nuk i bëhet e ditur se një pjesë e përmbajtjes është ndikuar nga intelijenca artificiale. Ky punim do të bazohet në një monitorim tre-javor të përmbajtjes mediatike, ku do të analizohen raste të përdorimit të ChatGPT në redaktimin e teksteve gazetareske. Qëllimi është të vlerësohet ndikimi i këtij mjeti në cilësinë gjuhësore, ruajtjen e stilit të autorit dhe trajtimin e përmbajtjes me ndjeshmëri shoqërore e politike. Ky punim synon të sjellë një pasqyrë të qartë dhe të balancuar mbi rolin e ChatGPT në redaktimin gazetaresk, duke theksuar nevojën për përdorim të vetëdijshëm, etik dhe gjithmonë nën mbikëqyrjen e gjykitit njerëzor.

Fjalë kyç: ChatGPT, gazetari, redaktim, cilësi gjuhësore, etikë, intelijenca artificiale (IA)

Zëvendësimi dixhital: a e rrezikon intelijenca artificiale fuqinë punëtore?

Ejona Hoxha

Departamenti i Gazetarisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

Email: ejona.hoxha007@gmail.com

Abstrakt

Vetëm 3 vjet pas publikimit të ChatGPT, rëndësia dhe nevoja e tij në jetën e individëve dhe shoqërisë është rritur. Sot, më shumë se 43% e njerëzve në qytetet e zhvilluara përdorin inteligjencën artificiale në jetën e tyre të përditshme. Edhe pse tashmë një mjet i domosdoshëm për të asistuar në detyrat e përditshme, intelijenca artificiale ka hapur shumë debate, një prej të cilave është zëvendësimi i elementit njerëzor me sisteme të automatizuara. Pasiguria është një element që po ndjek shumë profesionistë në fusha të ndryshme. Studimet kanë treguar se shumë profesione mund të zëvendësohen nga intelijenca artificiale brenda pak vitesh, si dizajnerët grafikë, programues, ekspertë IT, por mund të zëvendësohen edhe profesione të tjera më kreative si specialistë marketingu. Prandaj, qëllimi i këtij punimi është të analizojë opinionin publik mbi inteligjencën artificiale dhe pasiguritë e këtij zhvillimi kolosal teknologjik në jetën e punonjësve, të cilët kategorizohen si në rrezik. Në këtë kuadër shtrohet edhe pyetja kërkimore: Si po ndikon përhapja dhe integrimi i inteligjencës artificiale në tregun shqiptar të punës në zëvendësimin e profesionistëve në fusha të ndryshme si dhe në perceptimin e pasigurisë nga punonjësit? Ky studim arrin në përfundimin se profesionistët e rinj, veçanërisht ata të punësuar kryesisht në fushën e teknologjisë së informacionit, ndihen të rrezikuar dhe e shohin intelijençën artificiale si një kërcënim për ekzistencën e tyre profesionale.

Fjalë kyç: intelijenca artificiale (IA), automatizimi i profesioneve, pasiguri në tregun e punës, profesione të rrezikuara, adaptimi teknologjik.

ChatGPT: Psikologu i ri virtual në epokën e inteligjencës artificiale

Gurjola Tare

Departamenti i Gazetarisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

Email: taregurjola@gmail.com

Abstrakt

Në jetën e zhurmshme, të rrëmujshme dhe të shpejtë që gjithsecili prej nesh po përjeton, mundësitë për të zhvilluar çrregullime të shëndetit mendor janë gjithnjë e më të mëdha. Po ashtu rritet nevoja për të folur me dikë që dëgjon, kupton dhe këshillon pa paragjykim mendimet apo veprimet e tua. Sipas të dhënave të publikuara nga Ministria e Shëndetësisë (2023), gjatë vitit 2023, numri i personave të shtruar në psikiatri në Shqipëri u rrit me 50%, ndërkohë që rreth 10,000 individë kërkuan ndihmë psikologjike. Këto shifra mund të jenë edhe më të larta, sepse tema të tilla janë ende tabu dhe aksesit për në profesionistët e shëndetit mendor është i kufizuar. Në këtë kontekst, Inteligjenca Artificiale (IA), përmes aplikacioneve si ChatGPT, mund të shërbejë si një formë e re për të ofruar mbështetje emocionale, veçanërisht në vendet ku aksesit ndaj ekspertëve të shëndetit mendor është i kufizuar. Ky studim synon të analizojë mundësitë që ofron AI në evidentimin dhe menaxhimin e hershëm të çrregullimeve psikologjike. Përmes analizës cilësore të përgjigjeve që ChatGPT jep në situata të sajara, krahasimit të tyre me ato të profesionistëve dhe nëpërmjet një pyetësori online mbi përvojat dhe perceptimet e përdoruesve, ky studim pritet të hedhë dritë mbi rëndësinë, efektivitetin dhe kufizimet që ka përdorimi i AI në fushën e shëndetit mendor.

Fjalë kyç: shëndeti mendor, psikolog virtual, inteligjenca artificiale, evidentimi i çrregullimeve psikologjike, ndihmë emocionale, ChatGPT.

Arsimi në epokën e AI dhe ChatGPT: Funksioni i tij, përfitimet praktike, sfidat dhe ndikimi afatgjatë që mund të ketë në sistemin arsimor

Klea Kapllani

Departamenti i Gazetarisë, Universiteti i Tiranës, Tiranë, Shqipëri

Email: kleaKapllani12@icloud.com

Abstrakt

Transformimi teknologjik që ka pësuar shoqëria jonë në epokën e inteligjencës artificiale (AI) ka ndikuar jo pak në mënyrën se si po zhvillohet procesi arsimor. ChatGPT, një sistem AI, zhvilluar nga Open AI, është një nga risitë më të dallueshme i cili ka gjetur vend gjithnjë e më shumë në klasat virtuale dhe fizike të këtij procesi. Ky punim synon të shqyrtojë rolin e ChatGPT si një mjet ndihmës në mësimdhënie dhe të nxënë duke analizuar funksionalitetet e tij, përfitimet praktike, sfidat dhe ndikimin afatgjatë që mund të ketë në sistemin arsimor. Ndër përfitime kryesore do të cilësonim qasjen e shpejtë në informacion, shpjegimin e koncepteve në mënyrë të thjeshtuar dhe ndihmën e personalizuar që ChatGPT ofron. ChatGPT mund të përdoret si një mësues virtual i cili ndihmon në detyrat e shtëpisë dhe të harton ese apo projekte. Në anën tjetër mësuesit mund të jenë përfitues të ChatGPT-së nëpërmjet krijimit të materialeve didaktike apo diversifikimit të metodologjive të mësimdhënies. Megjithatë, ekzistojnë pafund sfida dhe rreziqe serioze që kërkojnë një vëmendje të veçantë, të tilla si: përdorimi i AI për të shmangur përpjekjen personale, rënia e zhvillimit kritik dhe krijues, mungesa e vlerësimit të saktësisë dhe besueshmërisë së informacionit. Mbi të gjitha lindin probleme me natyrë etike dhe ligjore lidhur me të dhënat personale apo mënyrën se si teknologjia duhet të integrohet në mënyrë të qëndrueshme në sistemin arsimor. Në përfundim punimi vlerëson se, nëse ChatGPT përdoret në mënyrë të ndërgjegjshme, ai ka potencialin të shërbejë si një katalizator për përmirësimin e cilësisë së arsimit.

Fjalë kyç: Inteligjenca Artificiale, ChatGPT, arsim, etikë, transformimi i sistemit arsimor.

Roli i inteligjencës artificiale (AI) në transformimin e arsimit dhe medias sot: IA në shërbim apo në dëm të informimit dhe dijes?

Marjela Koka

Departamenti i Gazetarisë, Universiteti i Tiranës

Email: marjelakoka11@gmail.com

Abstrakt

Inteligjenca artificiale po riformëson ndjeshëm mënyrën se si krijohet dhe shpërndahet informacioni në shoqërinë e sotme. Platforma si ChatGPT, të pranishme gjithnjë e më shumë në jetën akademike dhe profesionale, ofrojnë akses të shpejtë dhe lehtësi në marrjen e dijes, por njëkohësisht sfidojnë mendimin kritik dhe kreativ. Mjete të tilla po ndryshojnë mënyrën si studentët mësojnë dhe si mësuesit strukturojnë procesin edukativ, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e të mësuarit. Ndërkohë, edhe media po përjeton një transformim përmes përdorimit të algoritmeve për përzgjedhjen dhe krijimin e lajmeve. Kjo ka zhvendosur fokusin nga gazetaria analitike dhe e verifikuar drejt përmbajtjeve të shpejta virale dhe të ndikuara nga interesat e klikimeve. Raste si fotot e rreme të arrestimit të Donald Trump apo titujt e krijuar automatikisht në portale shqiptare tregojnë se manipulimi i informacionit me ndihmën e AI është kthyer në një trend të kohës. Kjo rrit rrezikun për dezinformim dhe cenon rolin e medias si burim objektiv dhe kritik. Ky punim ka për qëllim të analizojë ndikimin e AI në dy shtylla kryesore: arsimin dhe median. Përmes analizës së rasteve konkrete në arsimin universitar dhe mediat online. Do të shqyrtohet sesi teknologjia po e zhvendos individin nga një mendues aktiv në një konsumues pasiv të informacionit. Në përfundim kërkohet një ndërhyrje përmes edukimit mediatik dhe digjital, reformave në mënyrën e prodhimit të lajmeve dhe rishikimit të qasjes ndaj mësimdhënies, në mënyrë që teknologjia të vihet në shërbim të së vërtetës dhe dijes, e jo të bëhet burim manipulimi apo zbehjeje mendimi.

Fjalë kyç: inteligjenca artificiale (IA), gazetari digjital, manipulim informacioni, edukim, mendim kritik, algoritme, dezinformim.

Solving the Puzzle of Speech Sounds in English Language: AI Prompts for Improvement in Pronunciation

Natka Jankova Alagozovska

Faculty of Philology, Goce Delcev University, Stip

Email: natka.alagozovska@ugd.edu.mk

Abstract

Phonemes and allophones are speech units that help to solve the puzzle of speech sounds in English language. Each system is language specific. Hence, there is a big difference between Macedonian and English language. Very often differences are not accessible to the sense of hearing. By using modern phonetic instruments, sounds are transformed into visible records which make differences more noticeable. Additionally, AI can be also helpful in defining and distinguishing allophones and phonemes. This study will define phonemes and allophones while also providing phoneme-based and allophone-based AI prompts for pronunciation improvement. Variations in sounds occur across connected speech for various reasons, such as background noise, the speaker's fatigue, distraction, or reluctance to repeat. Furthermore, the speaker's linguistic background can influence these variations. Studying and improving both distinctive and non-distinctive features can help in understanding these changes, which often lead to miscommunication.

Keywords: Phonemes, Allophones, AI, Pronunciation, English language, Speech.

Pse edukimi mediatik s'ka të bëjë me edukimin në marrëdhëniet publike?¹

Hasan Saliu

Kolegji AAB, Kosovë

Email: hasan.saliu@aab-edu.net

Abstrakt

Ky punim trajton hendekun ndarës midis njohurive mbi median dhe njohurive mbi marrëdhëniet me publikun (PR), duke theksuar ndikimin e thellë që PR ka në përmbajtjen mediatike. Të ndërthurura historikisht, gazetaria dhe marrëdhëniet publike kanë një të kaluar konfliktuoze dhe bashkëvepruese. Përmes analizës kritike, punimi zbulon se, pavarësisht ndikimit të PR në përmbajtjen mediatike, tekstet e edukimit mediatik megjithatë kanë lënë pas dore përfshirjen e specifikave të marrëdhënieve publike. Kjo është e dukshme edhe në dy tekstet kryesore të edukimit mediatik të dekadave të fundit - Potter (2021) dhe Baran (2023). Mungesa e teksteve të edukimit në marrëdhëniet publike (PR Literacy) është e dukshme. Përveç një artikulli nga Holladay dhe Combs (2013) që prezantoi konceptin “edukim në marrëdhëniet publike”, nuk ka trajtime të tjera. Punimi thekson se PR dhe gazetaria ndryshojnë për nga natyra dhe qëllim dhe kështu edukimi mediatik nuk mund ta përfshijë plotësisht edukimin në PR. Prandaj rekomandohet thellimi i studimeve në edukimin e marrëdhënieve publike (PR Literacy), veçanërisht në epokën aktuale të pas së vërtetës, censurës së turmave online dhe rolit në rritje të inteligjencës artificiale si një informues dhe aktor komunikues në PR.

Fjalë kyç: edukim mediatik, marrëdhënie publike, edukim në marrëdhëniet publike (PR Literacy), gazetari, post-e vërteta, inteligjencë artificiale.

¹ Ky prezantim është pjesë nga studimi i cili pritet të botohet gjatë majit 2025 në revistën *Communication Research and Practice*, <https://doi.org/10.1080/22041451.2025.2494366>

Katalogimi në botim – (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

004

Book of Abstracts : International Conference : artificial Intelligence (AI) in the Age of Transformation : Opportunities and Challenges / organized by AAB College. - Prishtinë : Kolegji AAB, 2025. - 120 f. : ilustr. ; 25 cm.

ISBN 978-9951-832-30-4

ISBN 978-9951-832-30-4



9 789951 832304